



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr. 1327/3 Prot

Tiranë, më 31/8/2021

VENDIM

Nr. 43, datë 31 . 8 .2021

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi z. _____, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 1327 Prot., datë 04.08.2021, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik “Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale” (në vijim “Autoriteti Publik”).

Ankuesi, në cilësinë e kërkuesit, nëpërmjet e-mail-it datë 13.07.2021, depozituar në adresën nexhila.kodra@shendetesia.gov.al ka kërkuar t'i vihet në dispozicion dokumentacioni, në lidhje me:

1. *Procesverbali i mbledhjes së Komitetit të Ekspertëve të Imunizimit lidhur me diskutimin e përdorimit të vaksinës Coronavac, prodhuar nga Sinovac Life Science Vo Ltd.*
2. *Relacioni mbështesës i paraqitur nga relatori/relatorët përpara Komitetit të Ekspertëve të Imunizimit lidhur me përdorimin e vaksinave të mësipërme.*
3. *Rezultati i votimit të Komitetit të Ekspertëve të Imunizimit për aprovimin e vaksinës Coronavac.*
4. *Procesverbali i mbledhjes së Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga Coronavirusi i ri lidhur me diskutimin e përdorimit të vaksinës Coronavac, prodhuar nga Sinovac Life Science Vo Ltd.*

5. *Relacioni mbështetës i paraqitur nga relatori/relatorët përpara Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga Coronavirusi i ri lidhur me përdorimin e vaksinës së mësipërme.*
6. *Rezultati i votimit të Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga Coronavirusi i ri për aprovimin e vaksinës Coronavac.*
7. *Procesverbali i mbledhjes së Komitetit të Etikës lidhur me diskutimin e përdorimit të vaksinës Coronavac, prodhuar nga Sinovac Life Science Vo Ltd.*
8. *Relacioni mbështetës i paraqitur nga relatori/relatorët përpara Komitetit të Etikës lidhur me përdorimin e vaksinës së mësipërme.*
9. *Rezultati i votimit të Komitetit të Etikës për aprovimin e vaksinës Coronavac.*
10. *Kopje të korrespondencës elektronike ose tjetër të shkëmbyer midis tre Komiteteve të mësipërm, si dhe midis tyre dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.*

Në mungesë të një përgjigje nga ana Autoritetit Publik, me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, ankuesi ka paraqitur ankim pranë Komisionerit, duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Zyra e Komisionerit pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, në përputhje me përcaktimet e nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” (në vijim “LDI”).

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon: “*Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur*”, Komisioneri, me shkresën nr. 1327/1 prot., datë 05.08.2021 ka kërkuar nga Autoriteti Publik të informohet mbi trajtimin apo procedurën e ndjekur lidhur me kërkesën për informacion, brenda datës 12.08.2021.

Në tejkalim të afatit të mësipërm, Autoriteti Publik me shkresën nr. D-38/2 Prot., datë 20.08.2021, administruar pranë Zyrës së Komisionerit me shkresën nr. 1327/2 Prot., datë 24.08.2021 ka kthyer përgjigje duke argumentuar se: “*Në bazë të ligjit Nr. 15/2016 “Për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Infektive”, organet kolegjiale janë organe këshillimore të ngritura pranë ministrit përgjegjës për shëndetësinë. Të gjitha vendimet e këtyre komiteteve janë bërë publike nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale*”.

Pas konsultimit të legjislacionit përkatës dhe dokumentacionit të administruar, Komisioneri vlerëson se, qëndrimi i mbajtur nga Autoriteti Publik dhe argumenti i dhënë se të gjitha vendimet e këtyre komiteteve janë bërë publike nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nuk është në përputhje me parashikimet e LDI.

Konkretisht, Komisioneri konstaton se, Autoriteti Publik në përgjigjen e dhënë është shprehur se informacioni i kërkuar është bërë publik, por nuk i ka referuar kërkuarit adresën e saktë të faqes apo linkun se ku mund të gjendet informacioni, në bazë të pikës 2 të nenit 16 të LDI, sipas së cilës: “2. *“Kur informacioni kërkohet në format elektronik dhe ai gjendet në internet, autoriteti publik i tregon menjëherë kërkuarit adresën e saktë të faqes se ku mund të gjendet informacioni...”*. Për rrjedhojë, Autoriteti Publik nuk ka vënë në dispozicion të kërkuarit informacionin e kërkuar.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, informacioni i kërkuar në parim përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, sipas të cilit *“informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik*. Në këtë kuptim, Autoriteti Publik duhet të vendosë në dispozicion të kërkuarit çdo informacion/dokument i cili është prodhuar ose mbahet nga ky i fundit në formën e disponuar.

Ndërkohë, në shkronjën a) të pikës 2 të nenit 10, të LDI, parashikohet se: *“Koordinatori për të drejtën e informimit... a) i mundëson çdo kërkuar të drejtën për t’u njohur me informacionin publik, sipas këtij ligji, duke u konsultuar me dokumentacionin origjinal ose duke marrë një kopje të tij;”*.

Autoriteti Publik për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar duhet të mbajë në konsideratë parashikimin sipas pikës 6 të nenit 17 të LDI, sipas të cilit: *“Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarit. Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim”*.

Në pikën 3 të nenit 3 të LDI, *“Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”*.

Gjithashtu, bazuar në nenin 15 të po këtij ligji, *“autoriteti publik trajton kërkesën për informim brenda 10 ditëve pune nga data e dorëzimit të saj”*. Ndërkohë në pikën 1, të nenit 18 parashikohet se *mosrespektimi i dispozitave të këtij ligji, passjell përgjegjësi administrative*. Në pikën 2, të nenit 18 parashikohet se *veprimet dhe mosveprimet, në përputhje me këtë ligj dhe për aq sa nuk përbëjnë vepër penale konsiderohen kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë personat përgjegjës*.

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës nr. 1327 Prot., datë 04.08.2021 nga z. _____, kundër Autoritetit Publik “Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale”, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit sipas kërkesës për informacion datë 13.07.2021, duke respektuar kufizimet, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, brenda datës 08. 8 .2021.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
4. Ky vendim u shpall sot në datë 31 . 8 .2021.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

